

THE MEDIA OF ALBANIAN DIASPORA: A CHALLENGE BETWEEN THE NATIONAL IDENTITY AND GLOBAL TREND MEDIA SHQIP E DIASPORËS: SFIDA MES IDENTITETIT KOMBËTAR DHE TENDENCEVE GLOBALE

VALBONA KARAKACI

Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Shkodër, ALBANIA
valbonakarakaci@yahoo.co.uk

AKTET V, 4: 747 - 753, 2012

PERMBLEDHJE

Trajtimi i çështjeve kombëtare dhe i atyre të identitetit u duk sikur do të flakej si një rrobë e konsumuar. Mirëpo anomalitë e shoqërive multikulturore në Europë apo sfidat e atyre multi-etnike në Ballkan e kanë risjellë çështjen e kombësisë në tryezën e politikbërësve e në mënyrë të ndërsjelltë edhe në atë të shkencës e kulturës. Shqyrtimi i Kohës Javore na mëson se dilemat e identitetit shqiptar në Mal të Zi nuk janë vetëm kulturore, por edhe politike, ekonomike e ligjore. Vlerësimet e konkluzionet diakronike, për këtë çështje, janë të një rëndësie parësore për të vërtetuar potencialin integrues të identitetit dhe të pakicave kombëtare, por mbikqyrja e rregullt e sistematike në kontekstin kompleks në të cilin po zhvillohen ngjarjet në Ballkan është një tjetër dimension i qënësishëm.

Fjalet kyce: identitet, pakica, ndërdisiplinar, publicistikë, mbarëkombëtar, etnotipi, panshqiptar, nacionalizëm

SUMMARY

The treatment of national and identity issues seemed that it would be thrown away like consumed clothes, which fit only for a museum. But the anomalies of multicultural societies in Europe or the challenges of the multi-ethnic ones in the Balkans, have re-brought the nation issue to the policymakers' table and in a reciprocal way to that of science and culture. The scrutiny of Koha Javore, teaches us that the dilemmas of identity are not only cultural, but also political, economical and legal. The diachronic evaluations and conclusions are of primary importance to prove the integration potential of the national identity and minorities, but a regular monitoring of the dynamics of its continuous reformulation bears a special importance in the complex context in which the events are developing in the Balkans.

Key words: identity, minorities, interdisciplinary, journalism, nationwide, etnotipi, panshqiptar, nationalism

Hyrje

Hulumtimi i mëposhtëm është rezultat i analizës së artikujve mediatikë që fokusojnë, në mënyrë të tërthorë apo të drejtëpërdrejtë, çështje të pakicave në përgjithësi dhe të shqiptarëve të Malit të Zi, në veçanti. Media e përzgjedhur është "e shkruar" për arsye lehtësie studimore: gazeta javore *Koha* (Podgoricë) për aktualitet, shkencë dhe kulturë, seria e botimit 2006-07 (numri i parë 21 shkurt 2002), themeluar nga Kuvendi i Republikës së Malit të Zi.

Përzgjedhja e viteve 2006-07 konsideron variabla të rëndësishme për analizën si:

- *plani i Ahtisarit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës*
- *vizita e presidentit amerikan Bush në Shqipëri*
- *njohja e pavarësisë së Malit të Zi (21 Maj 2006): Shqipëria më 5 Korrik 2006*
- *diskutimi i projekt Kushtetutës së Malit të Zi*
- *zgjedhjet parlamentare e lokale*

Rubrikat e analizuara (tema e dilema, trajtesë, fejton, ngjarje javore, kulturë, mozaik, ekonomi,

vështrime dhe opinion, intervistë, rajoni dhe bota) përmbajnë thujasë të gjitha zhanret gazetareske: publicistikë, intervistë, kronikë, editorial, analizë, lajm, raportim, ese, kritikë.

Jo rrallë, çështjet e identitetit shqiptar janë parë në dritën e miteve e legjendave, që në rastin më të parë të çmitizimit transformohen në anatemë për patriotizmin e munguar të autorit. Ideologjizimi i shkencës dje, dhe politizimi i saj sot, ka ndërprerë rrjedhën e natyrshme të zhvillimit të argumentave shkencorë.

Impulset nga thellësitë e nën-ndërgjegjes mbi origjinën e lashtë dhe rrënjët e shëndetshme të genit kombëtar kanë gjetur shtrat në fakte të natyrës *pasojë pa thellim të mjaftueshëm në arsye të tilla si mbijetesa e një kombi në udhëkryq të vazhdueshëm*.

Një e tillë histori ka legjitimuar situatën, ku argumenta të rëndësishëm mbi identitetin tonë janë shtjelluar nga personalitete në marrëdhënie sistematike me kulturën shpirtërore shqiptare në përgjithësi e letërsinë, gjuhësinë dhe historinë në veçanti (Debati i Kadaresë dhe Qosjes: Frashëri, 2006). Hulumtimi i mëposhtëm me objektiv publicistikën e shkruar nuk e tejkalon këtë *fatlumësi a fatkeqësi: fatlumësi* se impulset jo rrallë përkojnë me aso *të vërtetash* tek të cilat arsyeja shkencore arrinë me vështirësi, *fatkeqësi* se dialogu mbi identitetin shqiptar duhet rilidhur me zinxhirin e kontributeve serioze të albanologëve europianë dhe vendas, falë thelbit të vetëmjaftueshëm të origjinës sonë.

Këtij pasqyrimi të cilit vështirë t'i shpëtoshë, sidomos kur je pjesë e një pakice kombëtare, i shtohet edhe argumenti bashkëkohor, të cilin instinkti poetik i Podrimës e sjell në vëmendjen tonë, ndërsa rizbulon botën arbëreshe *identiteti i arbëreshit zu të varet nga faktorë qofshin ekonomikë, shoqëror a politikë. Ja dhe një barrë e rëndë: lufta psikologjike, rrymimet e brendshme*.

Nëse dikur arbëreshin e shqetësonin varfëria, malli për atdheun e përtej detit, emancipimi shpirtëror e kulturor, përpjekjet mbinjerëzore për të ekzistuar e ruajtur me çdo kusht identitetin dhe gjuhën, tani e tmerrojnë përplasjet nëpër botë, presionet brenda e jashtë hapësirës së tij, kontakti me të panjohurën. Kjo është edhe frika e

poetit. Mu për këtë nuk dëshiron të shkëputet nga Moti i Madh, as nga legjendat e Mitet (Podrimja, 2006). Kësisoj argumenti bëhet më serioz, ngase aryet që na lidhin me mitin e identitetit, janë sa të vjetra aq edhe bashkëkohëse. Sidoqoftë në qendër të tyre rrëmon PASIGURIA.

Kontribute publicistike në tharmëzimin e identitetit shqiptar nga prespektiva e pakicave

Koha Javore është laborator i gjetur për trajtimin e çështjeve të identitetit: profili shkencor dhe kulturor përbën potencial për ta parë fenomenin në të dy planet e tij *si impuls* dhe *si realitet*, ndërsa identifikimi me pakicën shqiptare në Malin e Zi shtron aspekte të *aktualitetit* apo *përditësimit të vazhdueshëm të identitetit nacional të pakicave*.

Pa u ndalur në mënyrë të veçantë në aspekte të cilësisë, por duke u përqendruar në kontributet që e kanë jetësuar produktin e këtij laboratorit, sa më poshtë, është një prezantim i tyre:

I. Prezantimi i aspekteve të historisë mbarëkombëtare dhe pikëtakimeve të saj me kulturën europiane dhe ballkanike

Trajtesa të tilla si simbolet kombëtare dhe pikëtakimet e tyre me kulturën ballkaniko-europiane, vijnë përmes prezantimit të heraldikës shqiptare, praktikuar në Shqipëri paralelisht me fillimet e saj në Europë, ndërsa heraldika e Arbërit shquhet si e para në Ballkan (Plaka, 2007). Simbolet qofshin këto pagane apo religjioze janë të ngjashme me ato të familjeve, shteteve apo mbretërive të kohës.

Një aradhë prijësish, perandorësh e ushtarakësh si Belisari, gjenerali ilir që pushtoi Romën e Kartagjenën; Justiniani (565), perandori i madh bizantin me origjinë shqiptare, që përgjatë 35 vjetëve të mbretërimit do të shënjojë shkëlqimin dhe përpjekjen e fundit të kësaj perandorie për tu kthyer në sukses; Skënderbeu (Doda, 2007) prijësi që i riktheu trevave shqiptare qytetet ilire të Tivarit, Ulqinit, Shasit dëshmojnë për kontributin e shqiptarëve në rrënjët e civilizimit europian.

II. Steriotipi ballkanik: kjo “përzjerje e madhe” dhe shqiptarët si pjesë e tij

Humnera që ndanë Ballkanin Perëndimor nga Europa nuk është as ekonomike, as administrative, por humane: garantimi i të drejtave të njeriut (Perkaj, 2007). Një theks i tillë sado që relativ, është i natyrshëm për natyrën e *Kohës Javore*, një tribunë për pakicat.

Ballkani ka prodhuar më shumë histori nga ç'mund të tresë. Gjurmë kritike të pasojave të kësaj historie gjenden dendur në artikujt e shqyrtuar. Reflektime mbi perandoritë, që kanë ushtruar diktatin, por edhe kulturën e tyre në gadishull – perandoria Romake, Austro-Hungareze, Otomane – prezantohen si një “e kaluar” që pulson në të tashmen. Ndër to, e ashtëquajtura Perandori e Dushanit, e vetmja perandori e mbarsur në brendësi të gadishullit të trazuar në shek. XIV ka çuar në gjakderdhje e megalomani të denja për mite. Plagë të tilla pa u harruar dëshmohen si të nevojshme për t'u kuruar (Gojçaj, 2007).

Me gjithë traumat historike dhe damkën e një kolektivit që pak i respekton anëtarët e vet (*shqiptarët shfaqen gjithmonë kundër vetes* – Rexhep Qosja) kodi etik i Kombit në nivel individual prezantohet si elitar. Shembulli i disidentit malazias Jevrem Bërkoviç, ardhur përmes shkrimeve të Podrimjes, është sa apokaliptik, aq edhe tragjik: *Krijuesi i vërtetë nuk mund të jetë ai që nuk është në gjendje ta dënojë pjellën e vet kur prish kodin etik të Kombit* (Podrimja, 2007). Në asonancë me të qëndron edhe anëtari tjetër i familjes së letrave Kadare: *Populli që nuk guxon të dënojë tradhëtinë nuk e meriton të jetë i lirë*.

Pjesë e përzjerjes Ballkanike ishte e keqja dhe e mira, besa dhe tradhëtia, lufta për liri dhe shovinizmi. *Koha Javore* nuk heziton t'i sjellë për publikun e gjerë këto dëshmi si mësim të së kaluarës për një lajmotivi të ri. Pranë lajmit të mirë se Ulqini bëhet anëtari më i ri i Asosacionit të Qyteteve Multietnike të Evropës Juglindore (Kohapress, 2006), qëndron proklamata e vjeshtës së 1912 - ë. Ai prag Luftë Ballkanike, kur Krajl Nikolla fton edhe vëllezërit shqiptarë nga Malësia që për dy vjet me rrallë të derdhen gjakun

së bashku me malazezë në luftën përfundimtare kundër Perandorisë Otomane. Premtimi se sado të çlirohej Tuzi e Malësia do të valvitej flamuri shqiptar në këto troje... nuk qe mbajtur.

III. “Vetëkritika” mbi etnotipin shqiptar dhe katarsisi përmes kryqëzimit të tij me veçori më gjithëpërfshirëse

Qëndrimi vetëkritik ndaj veçorive të etnotipit, një lloj sinqeriteti në kufijtë e naivitetit synohet të balancohet me vlerësimet e të tjerëve mbi racën shqiptare. Novak Kilibarda (Podrimja, 2007) sjell në vëmendje të lexuesve një numër rastesh ku historia e kulturës malazeze i ka dhënë vendin e vet në panteonin e saj shqiptarëve: Mark Milani tek *Shembuj burrërie e trimërie* flet në mënyrë të barabartë mbi virtytet etike dhe trimërinë e shqiptarëve dhe malazezëve; epi i Nikolla I *Kryengritja e malësorëve* glorifikon virtytet e mentalitetit dhe trimërinë e malësorëve shprehur në rezistencën antiosmane; poema *Kurora e maleve* e poetit të madh malazias Njegoshit i thur lavde figurës së Skendërbeut.

Duket sikur dikotomia Shqipëri (të vetëquajtuarit) – Albania (të quajturit nga të tjerët) rishfaqet si pjesë e një dyzimi prej të cilit vështirë të thuhet sa të mira e sa të këqija ka pasur kombi shqiptar. Megjithatë, në *Koha Javore* gjejmë një numër përpjekjesh për të shpjeguar raste kontradiktore të kësaj dikotomie. Kështu, arsyeja se përse nga njëra anë shqiptarët mbrojnë me shpirt traditën, zakonet, gjuhën dhe përkatësinë kombëtare dhe nga ana tjetër asimilohen me lehtësi në shoqërinë amerikane, shpjegohet (Lulshi, 2007) me ligjësitë e shoqërive individualiste apo me mungesën e etnocentrizmit. Një numër veçorishë të tipit jo etnocentrik krijojnë simetri me tiparet e shqiptarëve:

- a. prirja për të mos rënë dakort me politikat e grupit ku bëjnë pjesë;
- b. prirja për ta parë fatin personal jashtë fatit të përbashkët të grupit;
- c. prirja për përbalimin e situatave të vështira;
- d. prirja për mikpritje, mirësjellje, qëndrimi pozitiv ndaj të huajve apo pjesëtarëve të tjerë të grupit.

Një tjetër gjetje për balancimin e tipareve negative të etnotipit është analizimi i tyre në suazën e një konteksti më të gjerë p.sh. shpjegimi i *fenomenit nepotizëm* (Berisha, 2006). I tillë është arsyetimi mbi mungesën e aftësisë shtetformuese të shqiptarëve në raport me vendet e tjera – që e ka zanafillën në kushtet historike shtypëse, denigruese dhe autoizoluese që ka kaluar bota shqiptare pas shthurjes së Perandorisë Otomane – shenjuar në primitivitetin e jetës sociokulturore dhe në mungesën e traditës juridiko-shtetërore, në rënien pre të inateve dhe mlllefeve primitive ballkanike, e për rrjedhojë mbytjen në interesa të vogla e të ngushta brenda *llojit, fisit, mëhallës* pa pasur një vizion të qartë, largpamës e bashkëkohor.

Një tjetër artikull shpjegon origjinën historike të nepotizmit nga *nepos-nip*, i njohur si fenomen që nga koha e Papëve, të cilët për të forcuar pozitën në Romë shpërblejnë, favorizojnë dhe sigurojnë dominimin e anëtarëve të familjeve të tyre; gjatë Rilindjes në shek XII-III i transformuar në një sistem nga i cili familjarët përfitonin prona, provinca, shtete; sikurse në ditët tona rasti i vëllezërve polakë e ndërkombëtarizon fenomenin.

IV. Promovimi i ekzistencës së një rrjeti panshqiptar dhe vitalizimi i tij në shërbim të çështjes kombëtare

Rrjeti panshqiptar prezantohet përmes historisë së shqiptarëve të Amerikës, e një rëndësie të dorës së parë për pakicën shqiptare në Malin e Zi. Parashtesat mbi organizatat, shoqatat, grupimet, individët, bashkësi të tilla si *Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan* dhe *Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane*, apo *Lëvizja Atdheu na Bashkon* (Kallaba, 2007) në shërbim të interesave të pakicës shqiptare në Malin e Zi janë pjesë e aktualitetit mediatik në *Koha Jovore*. Promovimi i medias shqip realizohet përmes sjelljes në vëmendje të lexuesit të fakteve si programi radiofonik i komunitetit të Miçiganit me një kohëzgjatje prej 25 vjetësh, radioprogrami shqip në Florida etj.

Shoqëritë kulturore, janë një tjetër hapësirë e rëndësishme për ruajtjen e trashëgimisë

kulturore dhe forcimin e urave të bashkëpunimit në Ballkan. Ato kanë luajtur një rol vendimtar në krijimin e shtetit shqiptar e sot e kësaj dite vazhdojnë të jenë vatra të rëndësishme të integritetit ballkanik.

Të tilla në faqet e *Koha Jovore* janë shoqëria *Migjeni* (Simiçiç, 2007) themeluar më 1989 në Lubjanë me organ promovuese fletushkën *Alternativë, Bashkësia Kulturore e Shqiptarëve të Rumanisë* (Ymeri, 2006), e vetmja organizatë tradicionale e komunitetit shqiptar në Rumani.

Filantropia nuk është një fenomen i përhapur në historinë e Shqipërisë. Më së shumti filantropët kanë qenë udhëtarë të befasuar nga pasuria shpirtërore dhe natyrore e viseve shqiptare. Megjithatë në artikujt e shqyrtuar nuk mungojnë rastet e filoshqiptarëve si Prof. Dr. Nicolae Ciachir (kryetar i Shoqatës Rumune për Ballkanistikë dhe Sllavistikë), Rose Wilder Lane (autore e librit *Travels with Zenobia: Paris to Albania by Model T Ford*, punojëse e Kryqit të Kuq, nënë adoptive Rexhës, një malësor që i pat shpëtuar jetën teksa udhëtonte viseve të Shalës: Lulushi, 2007).

V. Personalitete me zëdhënie në kulturën mbarëshqiptare, tematika e nacionit në sferën e artit e kulturës

Panteoni i personaliteteve të kulturës shqiptare që kanë zënë vend në *Kohën Jovore* është mbarëshqiptar: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Çamëria, shqiptarët e Rumanisë, arbëreshët apo diaspora në Perëndim me një spektër të gjerë tematik nga letërsia, publicistika, përkthimi, albanologjia, gjuhësia, monografia, artet pamore etj.

Shpesh autorët veçohen edhe në këndvështrimin e *kombësisë* si tematikë: kështu Idriz Berisha (Buzhala, 2007) është piktori kosovar, që pasi ka humbur mes flakëve të dhunës etnike pikturat e tij, i rikthehet Drinit të Bardhë si vija që bashkon botën shqiptare përmes të kaltrës e të bardhës; Ibrahim Kadriu (Ukaj, 2007) risjell poezinë shqipe për lexuesin rumun (kontributi i rumunëve dhe komunitetit shqiptarë atje është një nga më të spikaturit në pavarësinë e Shqipërisë) duke shpalosur pradigmën e fortë të fatit kolektiv tragjik; Nikoll Berisha (Simiçiç, 2007) me

përkthimet e tij ecën në gjurmët e linguistëve të mëdhenj sloven Miklloshiçi, Kopitari, Çopi e veçanërisht Rajko Nachtigalli; përkthimi i suksesshëm, edhe pse nga serbishtja, i *Antologjisë së poezisë së shqiptarëve në Jugosllavi*, të botuara në Cankarjeva Zalozhba më 1979 është shenja e mirë se kultura mund të jetë misionare e paqes në gadishullin e trazuar.

Hendeku mes politikës dhe të kulturës, ku kësaj të fundit jo rrallë i duhet të tejkalojë të parën në emër të njerëzimit, si një konstitucion më afatgjat se qëndrimet e përkohshme politike vjen e mbruhet në qëndrime të tilla si ai i poetit serb Milan Nikoliq, që pat shkruar në mbrojtje të *"Fëmijëve shqiptarë: I shoh tek më përshëndesin / me gishtërinj të hapur- / buqetë e buzëqeshur"* (Podrimja, 2007).

Analiza krahasuese e rrjedhave postmoderne në letërsinë ballkanike (letërsia malazeze, kosovare, kroate, slovene ku sipas autorit të shkrimit në fjalë më i shenjuari rezulton Radovan Karaxhiq me librin *"Mysafiri Sloven"*) është pjesë e hulumtimit për një kulturë të përbashkët që e tejkalon vetë temën e kombësisë (Karagjuzoviq, 2006). Tendenca e postmodernizmit për një ridimensionim të traditës përkundrajt modernizmit që synonte shpërbërjen e konvencioneve të ngulitura, merr një domethënie të veçantë në kontekstin e aspiratave të vendeve ballkanike.

VI. Informim, ndërgjegjësim dhe debat mbi të drejtat e pakicave

Debati mbi projekt kushtetutën e Malit të Zi dhe riformulimin e simboleve të tij në kuadër të pavarësisë zë një vend të rëndësishëm në serinë e shqyrtuar. Diskutimi mbi përcaktimin e shtetit malazez si *shtet i qytetarëve, popujve* apo *malazezëve dhe popujve të tjerë* anon nga shteti i qytetarëve, ndërsa vendi i shqiptarëve si *pjesëtar të popullit shqiptar, popull pakicë, pakicë nacionale* prioritarizon variantin e parë (Draga, 2007). Një qëndrim i tillë përbën distancim të qartë ndaj çdo hamendësie për një projekt nationalist brenda shtetit të ri malazez, pa bërë lëshime mbi të drejtat si populli i vetëm autokton, pakicë në Malin e Zi.

Pavarësisht prej statusit prej pakice autoktone, qëndrimi i shqiptarëve mbi simbolet shtetërore të një shteti multikonfesional, multikulturor, shumënacional shënjon një akt tolerance në raport me pakicat e tjera joautoktone: simbolet duhet të jenë të pranueshme për të gjithë (Karamanaga, 2007).

Kërkesa për krijimin dhe finançimin e *institucioneve të identitetit nacional, fetar dhe kulturor*, veçanërisht në fushën e edukimit gjendet e artikulluar nga figura të politikës dhe kulturës shqiptare në faqet e *Koha Javore*.

Fakteve me vlerë juridike si anëtarësimi i Malit të Zi i 47-ti vend në Këshillin e Europës (Linden, 2006) i bëhet jehonë duke vënë theksin edhe në detyrimet, që anëtarësime të tilla shtrojnë për respektimin e pakicave.

Përkundër sa më lart, në median në fjalë janë denoncuar edhe akte të shkeljes së të drejtave të pakicave si p.sh. iniciativa e Partisë Socialiste Popullore për vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së Statutit të Komunës së Plavës (Perkaj, 2007), që parasheh emërtimet zyrtare edhe në gjuhën shqipe përveçse në atë sllave.

VII. Diasporat dhe potenciali ekonomik e politik si kundërpeshë ndaj sindromit nationalist

"Mos u lodhni me çështjet kombëtare, sepse në standardin e jetesës askund nuk shkruan shqiptar, malazez, anglez, rus. Çështjet nacionale më mirë mund të zgjidhen atëherë kur standardi të jetë i lartë" - shprehet Sead Osmani (Osmani, 2007), ndërkohë që projekti evropian në thelb ngelet një projekt ekonomik dhe politik, duke njohur e respektuar diversitetin kulturor të popujve.

Dinamika dhe arsyet historike të krijimit të pakicave shqiptare në vendet e rajonit nuk i kanë shpëtuar interesit të *Kohës Javore*. I tillë është cikli që prezanton historinë e diasporës shqiptare në Bosnje Hercegovinë (Ahmetaj, 2007), që nga Lufta e I Botërore deri në ditët tona. Analiza është e pasuruar me të dhëna statistikore progresive mbi demografinë, arsyet e shpërnguljes, moshën, shpërndarjen gjeografike. Në mënyrë të ndërsjelltë përpjekjet për ndryshimin e strukturës etnike të popullsisë në favor të asaj sllave në trevat e Ulqinit përvijohen

në kuadër të një ciklit të gjerë (Avdiu, 2006) mbi veçorit e zonës ndërkufitare mes Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Përpjekja e diasporës për të ndihmuar ekonomikisht vendin amë nga një këndvështrim politik liberal, por edhe patriotik vjen përmes rasteve të tilla si ai shqiptaro-amerikanit Rifat Tirana, një prej arkitektëve të Planit Marshall, krahu i djathtë i gjeneralit George Marshall. Pas luftës Tirana kishte takuar pa sukses disa krerë politikë shqiptarë në mërgim mes tyre edhe Mithat Frashërin, për dërgimin e fondeve në Shqipëri.

Mobilizimi i kapitalit të diasporës shpaloset si shprehje e vullnetarizmit nga njëra anë, por edhe si strategji për sigurimin e një pozite të favorshme të kapitalit nacional në tregun e investimeve nga ana tjetër. Në SHBA sot jetojnë 10 000 familje shqiptare nga Mali i Zi, sikur çdo familje të kishte dhënë 1 USD në ditë kontributi vjetor do ishte 3 650 000 USD/vit (Gjonlekaj, 2006), ndërsa shumë kujt nuk i ka interesuar që potenciali i madh i diasporës, të investohet në mënyrë të organizuar në radhë të parë, sepse do konkuronte me ide dhe projekte të mira dhe çka i dhemb më së shumti biznesit vendas, me financa që kanë prejardhje të pastër (Camaj, 2007).

Potencialit ekonomik të diasporës i njihet kontributi i ruajtes së një numri enkalavash shqiptare (Malësia, Plava e Gucia) në Malin e Zi, të cilat përveçse prej emigrimit që shoqërohet me tendencën e zbrazjes totale, kërcënohen seriozisht edhe nga boshnjakëzimi, - dukuri kjo e hershme ndër vendbanimet shqiptare (Berishaj, 2006). Varësia ekonomike nga donacionet e familjarëve në diasporë ndikon edhe në mënyrën e organizimit të jetës së komuniteteve. Për rrjedhojë, *modelet e importuara* në shkëmbim të vazhdueshëm me *modelet e ngulitura vendase* me gjasë mund krijojnë një etnotip të ri.

Përfundime

Ndryshe nga ç'mund të pritej nga një pakicë e e ekspozuar ndaj asimilimit, shqiptarët e Malit të Zi, përmes hapësirës publicistike të *Koha Javore*, kanë rikonfirmuar vetveten nëpërmjet identifikimit të pikëtakimeve me Europën dhe

sferën kulturore ballkanase. Të tilla pikëtakime janë pasuruar me një sens vetëkritik, kurajë kjo që dëshmon për qëndrueshmërinë dhe vitalitetin e thelbit kombëtar. Përkundër një kulture të izolimit me qëllim ruajtjen e thelbit etnik, platforma e *Koha Javore* promovon rrjetet panshqiptar kudo në botë si dhe personalitete të kulturës e artit, të cilët bukurmirë qëndrojnë e shijohen sa në hapësirën mbarëkombëtare, aq edhe në atë europiane e ballkanase. Tematika e kombit ngelet burim frymëzimi përkundrejt globalizimit, që pritej ta asgjësonte.

Trajtesa që, përpiqen të ndjekin dinamikën e identitetit dhe riformulimit të tij të vazhdueshëm varësisht nga zbatimi i së drejtës dhe zhvillimit ekonomik, dëshmojnë se diaspora shqiptare në Malin e Zi nuk është vetëm një etnitet kulturor, por edhe një komunitet me potencial përfaqësimi dhe ndikimi, i cili në hartën multietnike të Ballkanit dëshmohet e ndërjegjeshme për rolin dhe përgjegjësitë që bart.

Bibliografia

- AHMETAJ, Ibrahim (2007), Disa lëvizje demografike të popullatës shqiptare në Bosnje dhe Hercegovinë në shek.XX: *Koha javore*, Podgoricë, 10 maj. Rubrika *Fejton*.
- AVDIU, Nexhat (2006), Politika të ndryshme ndaj këtyre zonave: *Koha javore*, Podgoricë, 2 nëntor. Rubrika *Aspekte gjeografike të zonës ndërkufitare midis Shqipërisë e Malit të Zi*.
- BERISHA, Ibrahim (2006), Shfaqje imponuese primitive: *Koha javore*, Podgoricë, 12 tetor. Rubrika *Modeli Nepotik i Qeverisjes*.
- BERISHAJ, Anton K. (2006), Gjurmë formash specifike: *Koha javore*, Podgoricë, 7 shtator. Rubrika *Studim: Tri ambiente mikrosociale*.
- BUZHALA, Prend (2007), Shenja figurative e amësisë: *Koha javore*, Podgoricë, 21 qeshor. Rubrika *Arte pamore*.
- CAMAJ, Robert (2007), Në cepin e "The Eagle's Land": *Koha javore*, Podgoricë, 28 qeshor. Rubrika *Etnitë dhe multikompanitë*.
- DRAGA, Nail (2007), Avancimi i barazisë qytetare e nacionale: *Koha javore*, Podgoricë, 24 maj. Rubrika *Tema e dilema: shqiptarët dhe projekt kushtetuta e Malit të Zi*

- FRASHËRI, Kristo (2006), *Identiteti Kombëtar Shqiptar dhe Çështje të tjera*, Tiranë.
- GJONLEKAJ, Gjekë (2006), Historia e ngecur në vend: *Koha javore*, Podgoricë, 29 qeshor. Rubrika: *Politikanët shqiptarë dhe diaspora*.
- GOÇAJ, Anton (2007), Kam përjetuar katarzë: *Koha javore*, Podgoricë, 26 prill, Rubrika *Intervistë me studjuesin Prf. Dr. Novak Kilibarda*.
- HALIMEHMETI, Gazmir (2006), Mungesa e frymës së re: *Koha javore*, Podgoricë, 31 gusht, Rubrika *Fushata para Zgjedhjeve*.
- ISMAIL, Doda (2007), Skëndërbeu në Ulqin: *Koha javore*, Podgoricë, 21 qeshor, Rubrika *Lidhjet e Skëndërbeut me viset shqiptare në Malin e Zi*.
- KALLABA, Ismet (2007), Diaspora ka potencial të madh: *Koha javore*, Podgoricë, 31 maj. Rubrika *Intervistë me kryetarin e lëvizjes „Atdheu na bashkon“ Gjon K. Lulgjuraj*.
- KARAMANAGA, Ismet (2007), Të jemi të gjithë të barabartë: *Koha javore*, Podgoricë, 17 maj. Rubrika *Vërejtje dhe sugjerime për projektkushtetutën e Malit të Zi*.
- KARAGJUZOVIQ, Senad (2006), Hajde të luajmë rolin e artistit: *Koha javore*, Podgoricë, 5 tetor. Rubrika *Kulturë*.
- KOHA JAVORE (2007), Vazhdim i bashkëpunimit mes diasporës dhe vendlindjes: *Koha javore*, Podgoricë, 17 maj. Rubrika *Ngjarjet javore*.
- KOHAPRESS (2006), Ulqini, anëtar i ri i Asocacionit: *Koha javore*, Podgoricë, 13 korrik, Rubrika *Ngjarjet javore*.
- LINDEN (2006), Mali i Zi në Këshillin e Europës në janar: *Koha javore*, Podgoricë, 29 qeshor. Rubrika *Ngjarjet javore*.
- LULUSHI, Astrit (2007), Kur individualistët kolektivizohen: *Koha javore*, Podgoricë, 31 maj, Rubrika *Ese*.
- LULUSHI, Astrit (2007), Vëllezërit Rexh e Roxher dhe nëna e tyre amerikane: *Koha javore*, Podgoricë, 26 prill. Rubrika: *Jetë në udhëkryq*.
- OSMANI, Sead (2007), Standardi i lartë i zgjidhë edhe çështjet nacionale: *Koha javore*, Podgoricë, 14 qeshor. Rubrika *Tregu dhe kapitali*.
- PERKAJ, Xhoana M. (2007), Iniciativë e PSP në Plavë për ndërrimin e emërtimeve në gjuhën shqipe: *Koha javore*, Podgoricë, 17 maj. Rubrika *Opinione dhe Vështrime*.
- PERKAJ, Xhoana M. (2007a), Humnera: *Koha javore*, Podgoricë, 26 prill, Rubrika *Ballafaqim*.
- PLAKA, Armand (2007), Heraldika shqiptare, vlerat e një tradite në ringjallje: *Koha javore*, Podgoricë, 17 maj, Rubrika *Fejton*.
- PODRIMJA, Ali (2006), Gjakimi për rikthim: *Koha javore*, Podgoricë, 9 tetor, Rubrika: *Ese*.
- PODRIMJA, Ali (2007), Kodi etik i Ballkanit: *Koha javore*, Podgoricë, 26 prill, Rubrika *Ese*.
- SIMIÇIÇ, Valentina P. (2007), Sikur t'i takoja sot ato mend, : *Koha javore*, Podgoricë, 26 prill. Rubrika: *Intervistë*.
- UKAJ, Ndue (2007), Universi i poezië së dhembjes: *Koha javore*, Podgoricë, 21 qeshor. Rubrika *Ese*.
- YMERI, Baki (2006), Bukureshti përkujton pavarësinë shqiptare: *Koha javore*, Podgoricë, 9 nëntor. Rubrika *Me rastin e ditës së flamurit*.